



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 38/ Prot.

Tiranë, më 24.04.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 24.04.2020, ditë e premte, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zhvilloi mbledhjen plenare të radhës nëpërmjet platformës online në lidhje skype/zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Znj. Nurihan Seiti
5. Z. Tartar Bazaj
6. Z. Bujar Sheshi
7. Z. Kosta Beluri
8. Z. Sandër Beci
9. Z. Vate Staka

Janë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT dhe EURALIUS.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë" i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve, bën hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:



1. Miratimi i projektit të Raportit Vjetor "Mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën janar 2019 - dhjetor 2019".
2. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër".
3. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës".
4. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër".
5. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
6. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
7. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
8. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
9. Miratimi i projektvendimit "Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër".
10. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Arben Smaçi.
11. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Afërdita Ndoi.
12. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Kolë Hysenaj.
13. Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Avni Kraja.
14. Miratimi i projektvendimit "Për transferimin e përhershëm të Kancelarit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar".



Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje apo komente për rendin e ditës.

Rreth kësaj çështjeje u diskutua:

Z. Staka kërkon që të hiqet nga rendi i ditës pika e katërbëdhjetë e tij.

Për dy arsye:

1. Duke patur parasysh rolin dhe funksionin e rëndësishëm, që do të ketë Kancelari në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), mendoj se nevojitet më shumë kohë dhe informacion, si për kandidaturat, ashtu edhe për procesin e përzgjedhjes.
2. Duke patur parasysh dy opinionet e dhëna nga insitucionet përkatëse lidhur me këtë çështje, edhe pse këto dokumente u janë vënë anëtarëve në dispozicion nga administrata e Këshillit, për shkak të situatës në të cilën po zhvillohet kjo mbledhje, mendoj se na nevojitet më shumë kohë.

Z. Ibrahim mendon se kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe se Këshilli ka patur kohën e mjaftueshme në dispozicion si për shqyrtimin e kandidaturave, ashtu dhe për procesin e përzgjedhjes së tyre. Ai referon vendimin e marrë në mbledhjen e mëparshme plenare për ngritjen e një grupi pune për ristrukturimin e administratës së SPAK-ut, që ka të bëjë në thelb me procedurën e mënyrës së lëvizjeve nga administrata e ish-Gjykatës së Krimeve të Rënda tek SPAK-u. Ky grup pune ka dalë me propozime për drejtuesin e SPAK-ut, i cili e ka marrë tashmë vendimin për të gjithë funksionarët e SPAK-ut; ndërsa vendimi për të emëruar kancelarin është kompetencë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Prandaj, propozimi është që Këshilli të vijojë me trajtimin e kësaj pike

Znj. Seiti shprehet që ky propozim të hidhet në votim.

Z. Staka kërkon që, për ekonomi gjyqësore, të hidhet në votim propozimi i tij për heqjen nga rendi i ditës së projektvendimit "Për transferimin e përhershëm të Kancelarit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar".

Z. Ibrahim hedh në votim propozimin e z. Staka.

Propozimi i z. Staka u rrëzua me 6 vota kundër dhe 3 vota pro (z. Staka, z. Balla, dhe z. Beci).

Në këto kushte, çështja e kancelarit të SPAK mbeti të trajtohet sipas rendit të ditës.

Z. Ibrahim vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimi i Projekt-Raportit Vjetor "Mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën janar 2019 - dhjetor 2019".*



Z. Ibrahim informon se në bazë të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli ka detyrimin që të raportojë një herë në vit para Kuvendit. Këshilli ka bërë një raportim të pjesshëm para Kuvendit, për periudhën që nga konstituimi i tij, pra, nga 19.12.2018 deri 31.07.2019. Meqenëse ishte një raportim i pjesshëm, Kuvendi nuk miratoi ndonjë rezolutë; Këshilli thjesht raportoi para Komisionit të Ligjeve. Tani është momenti që Këshilli të parashtojë një raportim të plotë vjetor për periudhën 19.12.2018 - 30.12.2019.

Ky projekt-raport vjetor përbëhet nga raportimi i pjesshëm (i depozituar në korrik) dhe nga raportimet vjetore të depozituara nga Komisionet që funksionojnë pranë KLP-së. Në të përshkruhen detyrat dhe kompetencat e Këshillit, mënyra e zhvillimit të seancave plenare, vendimmarrjet e Këshillit, caktimi i komisioneve, veprimtaria e tyre, relacionet, aktet nënligjore, vendimet, raportet etj.

Z. Staka shprehet se është njohur me raportin dhe pajtohet që ky të miratohet.

Z. Balla ndan të njëjtin mendim.

Znj. Seiti interesohet nëse do të miratohet raporti që i është shpërndarë Këshillit apo përmbledhja e raporteve të mëparshme.

Z. Ibrahim sqaron se bëhet fjalë për raportin që është shpërndarë, dhe vazhdon me leximin e projektvendimit si më poshtë:

Bazuar në nenin 149/a, gërma “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 181 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi:

Miratimin e Raportit të veprimtarisë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën janar 2019-dhjetor 2019.

Ky raport i dërgohet Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të rendit të ditës që kanë të bëjnë me caktimin e përkohshëm të një grupi prokurorësh në pozicione të ndryshme, pjesë e sistemit të prokurorisë.

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Beci të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.



Z. Beci lexon relacionet përkatëse që Komisioni ka përgatitur për bllokun e prokurorëve në fjalë, duke sqaruar se kemi të bëjmë me zgjatjen e afatit të këtyre prokurorëve, kryesisht për arsye të pozicioneve të lira të krijuara si pasojë e procesit të rivlerësimit.

Ai citon bazën ligjore, nenin 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Rregulloren e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr.15/04/2019 “Për Caktimin e Përkohshëm”, i ndryshuar me Vendimin nr.78, dt.04.03.2020, i cili hoqi edhe kufizimin për numrin e caktimeve të përkohshme. Në këto kushte propozohet që për këtë grup prokurorësh të caktohet edhe një afat tjetër tremujor për vazhdimësinë e tyre në pozicionet përkatëse.

Z. Ibrahim paralajmëron me këtë rast se shumë shpejt do të jetë gati dhe projekti i “Rregullores për ngritjen në detyrë”. Më pas i rikthehet leximit të projektvendimeve për caktimin e përkohshëm të 8 (tetë) prokurorëve për një afat 3- mujor (nga data 27. 04. 2020 deri më 26.07.2020), që KZHK ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit për miratim:

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të prokurores Afërdita Ndoi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Albert Murçaj në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Lazër Çardaku në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Lorenc Mërkuri në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Erion Çela në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Ludovik Doda në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Asllan Bajramaj në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet”.

Projektvendimin “Për caktimin e përkohshëm të z. Brahim Dragjoshi në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimeve për secilin prej 8 (tetë) prokurorëve.

Miratohe me 9 vota pro.



Z. Ibrahimi vijon me pikat 10, 11, 12 dhe 13 të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin z. Arben Smaçi.*
- *Miratimi e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren znj. Afërdita Ndoi.*
- *Miratimi e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin, z. Kolë Hysenaj.*
- *Miratimi e projektakteve të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin, z. Avni Kraja.*

Z. Ibrahimi i jep fjalën z. Beluri për të relatuar në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

Z. Beluri relatton projektaktet e vlerësimit për z. Smaçi dhe z. Hysenaj, për periudhën 2013-2016. Nga shqyrtimi i pesë dosjeve të përzgjedhura pranë prokurorive përkatëse dhe i tre akteve të dorëzuara nga këto subjekte, janë analizuar ankimimet nga prokuroria e Përgjithshme dhe të gjitha prokuroritë e shkallës së parë. Komisioni ka arritur në konkluzionin që raportimet janë të plota dhe i propozon Këshillit që t'i miratojë.

Z. Balla relatton projektaktin e vlerësimit për znj. Ndoi dhe shprehet se tashmë Komisioni është i konsoliduar në praktikën e procesit të rivlerësimit. Është ndjekur e njëjta praktikë vlerësimi, duke parë gjithë bazën dokumentare, formularët e vetëdeklarimit, dosjet e përzgjedhura, aktet përkatëse etj. Edhe për këtë prokurore nuk ka gjetje thelbësore negative, prandaj propozohet miratimi i projektaktit.

Znj. Keshi relatton për projektaktin e vlerësimit për z. Avni Kraja. Ndiqet e njëjta praktikë vlerësimi si për prokurorët e tjerë dhe, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, propozohet miratimi i projektaktit.

Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente të tjera.

Nuk ka.

Z. Ibrahimi lexon projektvendimet:

Bazuar në nenet 149/a, 179/b, aneksi "e", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 189/1, gërma "a" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së organeve së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar; nenin 40, 42 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenet 71 dhe 94 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me raportet e përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, vendosi:

1. Miratimin e projektvendimit për miratimin e raportit të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Arben Smaçi.
2. Miratimin e projektvendimit për miratimin e raportit të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokuroren Afërdita Ndoi.
3. Miratimin e projektvendimit për miratimin e raportit të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Kolë Hysenaj.
4. Miratimin e projektvendimit për miratimin e raportit të vlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar për prokurorin Avni Kraja.

Një kopje e këtyre vendimeve u dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimeve.

Miratohen me 9 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e fundit të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektvendimit "Për transferimin e përhershëm të Kancelarit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar".*

Z. Ibrahim: Në dhjetor 2019 Këshilli ka miratuar rregullat për transferimin e punonjësve të administratës së dy ish-Prokurorive të Krimeve të Rënda tek Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Këshilli ka dalë me një Urdhër për ngritjen e komisionit për ristrukturimin e administratës, në përbërje të të cilit ishin: Sekretarja e Përgjithshme e KLP-së, dy ish-drejtuësit përkatës të zyrave të ish Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe dy ish-kancelarët e tyre. Ky komision ka analizuar situatën dhe i ka propozuar Drejtuesit të SPAK-ut transferimin e të gjithë funksionarëve, me përjashtim të pozicionit të kancelarit, që është kompetencë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Komisioni i ristrukturimit i ka drejtuar Këshillit një raport ku shpjegohen hapat e ndërmarrë deri në propozimin për emërimin e njërit nga dy zonjat që kanë punuar si kancelare, përkatësisht në zyrat e dy shkallëve të ish Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Ka pasur një diskutim lidhur me interpretimin e dispozitave ligjore që rregullojnë transferimin e dy ish-kancelareve në pozicionin e kancelarit në SPAK. Në përpjekje për t'i bërë një interpretim sa më të mirë të mundshëm kësaj situatë ligjore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë u është drejtuar zyrtarisht me kërkesë për interpretim të ligjit, Komisionerit të Shërbimit Civil dhe Departamentit të Administratës Publike. Këto dy institucione, në përgjigjet e tyre, kanë punuar se mund të zbatohet transferimi i njërit prej dy kandidaturave në pozicionin e kancelarit pranë SPAK.



Për këtë arsye, Kryetari i parashtron Këshillit projektvendimin për transferimin e përhershëm të njëres prej dy ish kancelareve.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështjeje u diskutua:

Z. Beluri vlerëson se Këshilli është i vonuar në reagimin e tij mbi ligjshmërinë e këtij transferimi. Nisur nga përgjigja e ardhur nga KMSHC dhe DAP, ai konstaton se këto institucione nuk kanë bërë interpretim të drejtë të parashikimeve ligjore. Në përgjigjen e ardhur nga këto dy institucione thuhet se: “Kancelari i Prokurorisë së Posaçme, sipas përcaktimeve në ligj, rezulton se kryen detyra të njëjta funksionale me Kancelarin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pasi kërkesat specifike të vendit të punës, niveli i pagës dhe funksionet janë të njëjta”.

Duke iu referuar të njëjtit nen, të cilit i janë referuar dhe dy institucionet e sipërcituara (nenit 18/3 të ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”), ai citon se: “Kancelari i Prokurorisë së Posaçme barazohet në pagë dhe kryen funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme”.

Duke krahasuar nivelin e pagës që kanë patur kancelaret në Prokurorinë e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit (II b dhe III b), z. Beluri tha se Kancelari i Prokurorisë së Posaçme ka nivel page I-a. Për këtë arsye, ai mendon se transferimi nga funksioni i mëparshëm në pozicionin e ri nuk është lëvizje paralele, por ngritje në detyrë.

Z. Ibrahim sqaron se propozimi që i shtrohet sot Këshillit për vendim transferimi është ai i duhuri. Në rast se do të përdornim mekanizmin e ngritjes në detyrë, Këshilli do të duhej të kishte organizuar paraprakisht një procedurë për ngritjen në detyrë, dhe sot do të kishim 6 (gjashtë) kandidatura për Kancelar të Prokurorisë së Posaçme (të gjithë kancelarët aktualë në sistem).

Z. Staka i referohet ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, neni 18, pika 2, ku thuhet: “Kancelari i Prokurorisë së Posaçme kryen funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm për Prokurorinë e Posaçme”.

Ai ndan të njëjtin mendim me z. Beluri, duke sqaruar se pozicioni i kancelarit të SPAK-ut ndryshon me kancelarët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Për këtë arsye, ai kërkon kohë që Këshilli të marrë një vendim sa më të drejtë.

Z. Ibrahim sqaron se Këshilli i është propozuar që të miratojë sot një projektvendim.

Z. Beluri sqaron se qëndrimi i tij nuk duhet keqkuptuar, pasi ai është dakord që vendimi të merret sot, por duke u shprehur negativisht për mostransferim.



Z. Ibrahim thotë se Këshilli duhet të procedojë me transferimin.

Z. Beci i kërkon Këshillit kohë në mënyrë që të shqyrtohen mendimet e dhëna nga anëtarët.

Z. Ibrahim ndërpret mbledhjen plenare për t'u rikthyer pas 30 minutash (për arsye teknike të lidhjes me platformën ZOOM). Pasi Këshilli rimblidhet, ai i rikthehet diskutimit dhe relaton shkurtimisht opinionet e dy institucioneve si më poshtë:

1. Opinioni i KMSHC-së: Kancelarët që kanë kryer funksionet e tyre pranë ish-prokurorive të Krimeve të Rënda të të dy niveleve janë kandidatë për t'u transferuar në mënyrë të përhershme në pozicionin e Kancelarit në Prokurorinë e Posaçme.

2. Opinioni i DAP-it: Pozicioni ku mund të transferohen ish-kancelarët e Prokurorive për Krimet e Rënda mund të jetë pozicioni i Kancelarit pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit apo/ose ndonjë pozicion tjetër pranë këtij institucioni të krijuar rishtazi.

Mbi këtë bazë ka ardhur dhe vendimi i grupit të punës të ristrukturimit i cili i paraqet Këshillit projektvendimin.

Znj. Seiti paraqet opinionin e saj pro miratimit të projektvendimit, bazuar në dy argumente:

1. Baza ligjore materiale; ajo referon ligjin për funksionimin e KLP-së, ligjin për funksionimin e SPAK-ut, ligjin për funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme. Këto ligje organike janë instrumente thelbësorë të cilat edhe mund të ndërthuren me interpretime të një ligji tjetër. Por, sipas saj, baza ligjore për këtë transferim ekziston që ne të veprojmë në mënyrë të mëvetësishme.

Në nenin 44, pika 2 të ligjit Nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", ka një dispozitë "për statusin e punonjësit civil të administratës së prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme, i cili u nënshtrohet dispozitave të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj". Referuar dispozitës së posaçme të nenit 113 të ligjit Nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", nëpunësi civil i ish Prokurorisë së Krimeve të Rënda mund të kalojë në Prokurorinë e Posaçme, thjesht kur plotëson "kushtin e sigurisë".

2. Baza ligjore procedurale; ajo i referohet përsëri ligjit Nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 77 pika 6 e të cilit flet për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë. Aty thuhet : "... në rast se vendi është i lirë (dhe nuk plotësohet sipas dispozitave të mësipërme), KLP, për kancelarët, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, duke njoftuar edhe nëpunësit civilë të kategorive më të ulëta, të cilët plotësojnë kriteret për kategorinë përkatëse më të lartë".



Përderisa pozicioni i Kancelarit kryen funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm, argumenti i pa/barazisë në pagë, në këtë rast është dytësor dhe nuk mund të shërbejë si pengesë për transferimin. Për këtë arsye, secila nga të dyja kandidaturat kalon automatikisht në këtë pozicion.

Z. Staka i referohet ligjit 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", neni 18 i të cilit përcakton se: "Kancelari është nëpunësi civil më i lartë i Prokurorisë së Posaçme, i cili mbikqyr veprimtarinë e personelit administrativ, administron mjediset e punës, dosjet, arkivin, shërbimet mbështetëse dhe financat e Prokurorisë". Sa i takon barazimit në pagë me Sekretarin e Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme, disponon vetëm pika e tretë e këtij neni.

Z. Ibrahim pajtohet se kompetencat e Kancelarit të SPAK-ut dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme janë të njëjta, referuar nenit 18 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", si dhe nenit 55 të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Z. Beci argumenton se Kancelari i SPAK-ut, si nëpunësi më i lartë është edhe Nëpunës Autorizues (NA). Ai nuk mund të jetë i të njëjtit nivel me kancelarët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Kancelari i SPAK-ut është Nëpunës Autorizues i institucionit dhe dallon nga kancelarët e prokurorive të shkallës së parë dhe të apelit, të cilët nga ana buxhetore varen nga Prokuroria e Përgjithshme dhe si të tillë janë nëpunës autorizues të nivelit të dytë. Për këtë arsye, ata nuk janë në të njëjtin rang si nga ana funksionale, ashtu edhe ajo e trajtimit financiar apo e kompetencës.

Z. Balla shtron dy pyetje:

E para, meqë Këshilli është duke zhvilluar një proces vetingu për kancelarët në detyrë, si mund të transferohen këta të fundit në SPAK pa kaluar këtë proces?!

E dyta, meqenëse Kancelari i SPAK-ut barazohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme, a i plotësojnë kriteret këto kandidatura?

Në kuadër të ristrukturimit, atyre mund t'u ofrohet një pozicion tjetër në sistemin e prokurorisë. Ai pajtohet me z. Beluri, me argumentin që pozicioni i Kancelarit në SPAK nuk është i njëjtë me atë të kancelarit në ish-prokuroritë e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë apo të Apelit.

Z. Sheshi argumenton se ligji e bën qartë dallimin mes pozicionit të Kancelarit të SPAK-ut me pozicionin e kancelarit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Mund të ketë interpretime të ndryshme, po fundja ligji përcakton emërimin si Kancelar, jo si Sekretar i Përgjithshëm. Barazia funksionale është parashikuar për të theksuar pavarësinë e këtij pozicioni.

Përpos opinionit të dy organeve kompetente të sipërcituara, Këshilli duhet të marrë parasysh edhe shqetësimin që ka shprehur Drejtuesi i SPAK-ut për zgjidhjen e kësaj çështjeje sa më parë



dhe sa më drejt, për mbarëvajtjen e punës. Për këtë arsye, ai pajtohet që Këshilli duhet të marrë një vendim sot, në këtë mbledhje plenare.

Z. Ibrahim i përgjigjet shqetësimit të ngritur nga z.Balla lidhur me vetingun e kandidaturave, duke sqaruar se KLP praktikisht po bën një "transferim me kusht", pasi procesi i verifikimit të figurës së kancelarit do të kryhet nga vetë SPAK-u. Ne bëjmë transferimin dhe pastaj SPAK-u merret me verifikimin. Nëse zyrtari i transferuar nuk kalon vetingun, ai nuk konfirmohet në atë detyrë.

Sa i takon shqetësimit të mëpërparshëm lidhur me zyrtarët që futen në kategorinë e nivelit të lartë drejtues (TND), theksoj se në këtë kategori futen jo vetëm Kancelari dhe Sekretari i Përgjithshëm, por edhe drejtues të tjerë që janë një shkallë poshtë tyre.

Z. Sheshi shton se SPAK-u ka një komision të posaçëm që bën verifikimin e gjithë administratës së vet; ne nuk kemi përse të dublojmë këtë komision.

Znj. Keshi shprehet që verifikimi i pasurisë dhe figurës së kancelarit duhet bërë nga komisioni i posaçëm pranë SPAK-ut, referuar nenit 6 të ligjit Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Z. Ibrahim informon Këshillin se votimi do të bëhet duke patur përpara dy opsione:

1. Miratimi i procedurës së transferimit (2 kandidatë).
2. Miratimi i procedurës së ngritjes në detyrë (6 kandidatë).

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit për procedurën e transferimit.

Projektvendimi miratohet me 5 vota pro, përfshirë dhe atë të z. Bazaj, i cili e shprehu votën e tij përmes aplikacionit whatsapp dhe email.

Z. Ibrahim vijon me trajtimin e çështjes sipas projektvendimit të propozuar për procedurën e transferimit.

Z. Beluri është kundër, pasi është për procedurën e ngritjes në detyrë.

Z. Ibrahim lexon tre kriteret që duhet të përmbushin dy kandidaturat, znj. Dora Matia Gjirizi dhe znj. Laureta Binaj, si më poshtë:

1. Arsimi dhe kualifikimi në punë.
2. Vjetërsia në punë dhe në profesion.
3. Vlerësimet e rezultateve në punë.



Në bazë të këtyre kriterëve, grupi i ristrukturimit ka bërë një tabelë vlerësimi për secilën prej dy kandidateve.

Z. Ibrahim lexon vlerësimet përkatëse dhe pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështjeje u diskutua:

Z. Ibrahim shpreh opinionin e tij pro znj. Binaj, me argumentin se kjo kandidate ka më shumë eksperiencë në pozicionin e kancelares në sistemin e prokurorisë dhe, së dyti, ka përparësinë të ketë përpara më shumë vite karriere për të dhënë kontributin e saj në këtë pozicion.

Znj. Seiti ndan të njëjtën mendim me z. Ibrahim, duke u shprehur se znj. Binaj do t'i japë më shumë ritëm dhe qëndrueshmëri profesionale administratës së këtij institucioni.

Z. Staka ndan të njëjtin mendim me z. Ibrahim dhe znj. Seiti.

Z. Beci konstaton se znj. Binaj i ka kaluar të gjitha fazat brenda sistemit të prokurorisë dhe ka më tepër mundësi kohore për të dhënë kontributin e saj në këtë pozicion.

Z. Balla propozon që Këshilli të marrë në konsideratë edhe mendimin e z. Sheshi dhe z. Beluri, meqenëse ata kanë punuar në prokuroritë e Krimeve të Rënda.

Z. Sheshi vlerëson se të dyja kandidaturat i plotësojnë kushtet, por meqë znj. Matia është afër mbushjes së moshës së pensionit, ai është për kandidaturën e znj. Binaj.

Z. Beluri ndan të njëjtin vlerësim me z. Sheshi, por vazhdon t'i përmbahet qëndrimit të tij kundër procedurës së transferimit.

Z. Ibrahim lexon vendimin për transferimin e përhershëm të Kancelarit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si më poshtë:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 189 të ligjit nr. 115 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil"; nenin 86 të ligjit nr. 95/2016, pika 7, nenin 7 të Vendimit dt.19.12.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për miratimin e rregullave për transferimin në SPAK";

Pasi vlerësoi kandidaturat, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi transferimin e përhershëm të znj. Laureta Binaj në pozicionin e kancelares pranë SPAK. Znj. Binaj i nënshtrohet verifikimit të kushteve të sigurisë, sipas nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"



Në përfundim të verifikimit, të njoftohet znj. Binaj dhe ngarkohet Prokuroria e Posaçme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 8 vota pro. Z.Beluri ishte kundër procedurës/vendimit.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



Shënim. Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjitha procedurave të rishikimit.

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___/___/2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___/___/2020 (bashkëngjitur kopjet e dokumenteve). Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë ___/___/2020
Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

